

Tiranë, më 06.12.2019

Lënda: Shtojcë për modifikim në dokumentet e tenderit

Objekti i Prokurimit: “Kalibrimi i Pajisjeve”

Mbështetur në Nenin 42 pika 2, e Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe në Nenin 62, të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Njësia e Prokurimit, bën ndryshimin e dokumenteve standarde të tenderit, për procedurën E hapur - me mjete elektronike - Sherbime, me objekt “*Kalibrimi i Pajisjeve*”, me fond limit 9,900,000 (nente milion e nenteqind mije) Lekë pa TVSH, si me poshte:

I. Tek kriteret e vecanta te kualifikimit (Shtojca 8) pika 3.3.1

ISHTE

3.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Autorizimin/suportin e prodhuesit/distributorit te autorizuar te pajisjeve (CT Analizer OMICRON ; Votano OMICRON ; CMC 256 OMICRON ; CMC 256 PLUS OMICRON; CMC 356 OMICRON ; DTRS-6 ISA) i cili te shprehet se merr persiper te beje kalibrimin e ketyre pajisjeve. Autorizimi/suporti duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

BEHET

3.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese nje deklarate me shkrim nga :

- i) Prodhuesit ose distributoret e autorizuar te pajisjeve (CT Analizer OMICRON ; Votano OMICRON ; CMC 256 OMICRON ; CMC 256 PLUS OMICRON; CMC 356 OMICRON ; DTRS-6 ISA), Ose
- ii) Nje laborator i pavarur dhe i certifikuar, te cilat te shprehen se marrin persiper te bejne kalibrimin e ketyre pajisjeve.

Deklarata e leshuar nga Prodhuesit/distributoret e autorizuar te pajisjeve ose nga laborator i pavarur dhe i certifikuar duhet te permbaje te dhena te plota , si: telefon, fax, e-mail, website te leshuesit te deklarates, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

II. Tek kriteret e vecanta te kualifikimit (Shtojca 8) shtohet shenimi:

Shenim: Per te gjitha pajisjet, kur ne Termat e References kerkohet kalibrimi i tyre ne laboratoret e prodhuesit, shtohet termi, ose laboratoret e pavarur te certifikuar.

III. Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje shtyhet nga data 09.12.2019, ora 11:00 në datë 19.12.2019, ora 11:00.

Njesia e Prokurimit